

Njoftim vendimi



Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga Ina Rama kryesuese, Sokol Çomo relator, Mimoza Tasi, Natasha Mulaj, Rezarta Schuetz anëtarë, shpalli vendimin për çështjen (JR) nr. 17/2023, datë 05.05.2023 që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit Ornela Xhembulla kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 645, datë 11.04.2023. Në përfundim të gjyqimit në dhomë këshillimi, trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr.84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në mënyrë unanime, vendosi:

1. Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 645, datë 11.04.2023, që i përket subjektit të rivlerësimit znj. Ornela Xhembulla.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 27.07.2023.